




Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren



## KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 05.12.2023

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke u bazuar në nenin 10 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, me Nr. Prot. 01-197/A, të datës 11.05.2022, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, merr këtë:

### V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave eventuale të studentëve të pakënaqur me rezultatin e ndarjes së bursave, për vitin akademik 2022/2023, në përbërje si në vijim:
  - 1.1 Nexhmedin Krasniqi - Kryesues;
  - 1.2 Prof. Ass. Dr. Adelina Rakaj - anëtare;
  - 1.3 Prof. Ass. Dr. Jasmin Jusufi - anëtar;
  - 1.4 Riad Bislimaj (Student) - anëtar (pa të drejtë vote).
2. Komisioni vepron në bazë të ankesave të palëve dhe vendimet i merr në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 05/L -03, Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Universitetit, Rregulloren mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, me Nr. Prot. 01-197/A, të datës 11.05.2022, dhe konkursin për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2022/2023.
3. Afati për shqyrtim të ankesave nga komisioni për ankesa është 2 (dy) ditë pune.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

  
Kryesues i Këshillit Drejtues



Vendimi t'u dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Zyrës së personelit;
- Zyrës ligjore;
- Të përmendurve;
- Arkivit.